



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.22.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR
TË AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Valbona Tolaj – Udhëheqëse e ekipit dhe anëtarët Hysen Boqolli dhe Abdurrahmon Bërbatovci, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit - Bujar Sejdiu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	20
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	21
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	24
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	26

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se llogaritë e arkëtueshme janë mbivlerësuar për 154,018€.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm**

Drejtori i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARrU) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se vlera e llogarive të arkëtueshme është mbivlerësuar për 154,018€ sepse në këtë llogari gabimisht është prezantuar vlera e të hyrave të inkasuara. Kjo reflekton kontrolle të dobëta mbi vlerat e raportuara në PFV. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i Përgjithshëm i ARrU-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ARrU-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

ARrU kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK), etj.

Në draft PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare dhe ne kemi dhënë disa sugjerime për të përmirësuar shpalosjet përshkruese dhe për të siguruar plotësinë e shpalosjeve. ARrU në PFV-të finale kishte bërë disa përmirësime, mirëpo edhe me tutje janë identifikuar disa gabime, përkatësisht nuk ishin bashkëngjitur anekset e shpalosjeve.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipërpërmendur te opinioni i auditimit jepet rekomandimi:

Rekomandimi 1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në prezantimin e vlerave të raportuara në PFV-të 2017. Edhe aspektet tjera të pajtueshmërisë gjatë përgatitjes së PVF-ve duhet të adresohen. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet dhe rishikimet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ARrU-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vetëvlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda ARrU-së veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut, raportimin menaxherial dhe monitorimin efektiv të disa prej Kompanive Rajonale të Ujërave (KRU). Pyetësi i vetëvlerësimit, i plotësuar nga ARrU, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit ende nuk është në nivelin e kërkuar.

Përmbushja e obligimeve dhe zbatimi i planit të punës për vitin 2016 ka qenë mjaft sfidues për ARrU-në, për arsye të vonësës së zgjedhjes së menaxhmentit të lartë - Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kjo ka shkaktuar vonesa në disa aktiviteteve siç janë: Licencimi i ofruesve të shërbimeve, nxjerrja e urdhëresave tarifore dhe nxjerrja e udhëzimit administrativ për Taksën për licencë vjetore.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2015 të ARrU-së ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime kryesore. ARrU kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, dy (2) janë në proces të zbatimit, ndërsa dy (2) rekomandime ende nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Rekomandimi

Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Ndonëse menaxhmenti ka zbatuar një proces formal të menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, nuk është arritur që plani i veprimit të përmbushet në tërësi. Një pjesë e rekomandimeve kanë mbetur të pa zbatuara plotësisht.

Rreziku Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e kontrolleve të brendshme në sistemet kryesore financiare dhe menaxheriale, dhe si rezultat kemi përsëritjen e mangësive të njëjta nga viti në vit.

Rekomandimi 2 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.

2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të tij. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ARrU-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Pyetësi i vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga ARrU ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Ndonëse janë ndërmarrë disa hapa pozitiv, ende nuk ekziston një proces i mirëfilltë për menaxhimin e rrezikut siç e kërkon procedura e MFK-së; dhe
2. ARrU ka një plan pune për vitin 2016 por ende nuk ka e ka azhurnuar planin strategjik për mandatin e ri. Hartimi i strategjisë është konsideruar si i vendosur në pyetësorin vetëvlerësimit duke u bazuar në Planin Strategjik 2015-2017, mirëpo ky plan nuk është harmonizuar me përgjegjësitë e reja të përcaktuara me Ligjin¹ e ri.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda ARrU-së që ka të bëjë me rëndësinë e këtij pyetësi dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit me dokumentacionin mbështetës.

¹ Ligji Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ARrU operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Aranzhimet e monitorimit

ARrU ka obligim ligjor monitorimin e shtatë (7) KRU-ve të licencuara për të siguruar që po zbatojnë Ligjin dhe Rregulloret në fuqi, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së konsumatorëve.

Ligji i ri përveç që ka konfirmuar edhe një herë rolin dhe përgjegjësitë e rregullatorit, i ka definuar edhe më tej disa përgjegjësi në fushën e monitorimit, raportimit, inspektimit, si dhe shqyrtimin dhe aprovimin e akteve interne të ofruesve të shërbimeve si planet e biznesit, menaxhimit të asetëve, investimeve afatgjata, menaxhimit të thatësisë dhe furnizimit me ujë në situata të emergjencës. Po ashtu edhe ARrU shqyrton dhe aprovon edhe rregulloret dhe procedurat interne të ofruesve të shërbimeve lidhur me zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, kyçje të konsumatorëve në shërbime, matjen dhe faturimin dhe ndërprerjet e shërbimit.

Çështja 4 – Monitorim jo efektiv i KRU-ve – Prioritet i lartë

E gjetura Në pajtim me Ligjin e ri, Drejtori i Përgjithshëm me një urdhëresë ka zbritur taksën administrative për kyçje në rrjet nga 50€ në 5€ dhe është larguar gjoba 100€ për kyçje ilegale. Edhe pas këtyre akteve, nga raportet e inspeksionit të ARrU-së kemi gjetur që:

- KRU “Prishtina” kishte aplikuar taksën administrative për kyçje në vlerë 50€ tek 865 konsumatorë, KRU “Bifurkacioni” te 197 konsumatorë, dhe KRU “Mitrovica” tek 30 konsumatorë. ARrU kishte kërkuar nga KRU-të që të bëjnë ri-imbursimin e këtyre konsumatorëve por përmbushja e kësaj kërkesë ende nuk ishte konfirmuar; dhe
- KRU “Prishtina” kishte ngarkuar 99 konsumatorët me gjobë 100€ për kyçje. Pas rekomandimit nga ARrU ishte bërë korrigjimi te 79 konsumator duke aplikuar zbritje nga borxhi i përgjithshëm, ndërsa te 20 konsumator ende nuk ishin bërë korrigjime.

Drejtori i Përgjithshëm kishte dërguar paralajmërimet paraprake ndaj KRU-ve por ende nuk ishin arritur rezultatet e pritura.

Rreziku Aplikimi i gabuar i taksave dhe tarifave për shërbimet e ujit nga KRU-të rezulton me dëmtime financiare për qytetarët dhe me shkelje të së drejtës së konsumatorëve.

Rekomandimi 4 Drejtori i Përgjithshëm duhet të përcaktoj se pse monitorimi i KRU-ve nuk ka qenë efektiv dhe të ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar aplikim të drejtë dhe të vazhdueshëm të tarifave të KRU-ve ndaj konsumatorëve. Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i zbatojë procedurat e përcaktuara pas paralajmërimit në përputhje me afatet ligjore.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve të brendshme të zbatuara në sistemin kryesor financiar të ARrU-së ka nxjerrë në pah dobësi lidhur me raportim financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth ndryshimeve në buxhet dhe analiza lidhur me diferencat ndërmjet performancës së planifikuar dhe të realizuar.

Rreziku Cilësia jo e mirë e raportimit tek menaxhmenti i lartë e redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet në mënyrë pro aktive si dhe zvogëlon efektin e kontrolleve buxhetore. Ngjashëm mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 5 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2017.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

ARrU nuk i plotëson kriteret për të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 23/2009, për themelimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin publik.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ARrU ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Më gjithë progresin e arritur, në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një pjesë të pagesave, rekrutimin e stafit dhe aplikimin e softuerit E-Pasuria nuk kanë qenë sa duhet efektive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	180,018	180,018	187,412	336,989	364,370
Totali	180,018	180,018	187,412	336,989	364,370

Në vitin 2016 inkasimi i të hyrave kishte tejkaluar planifikimin për 7,394€. Të gjitha të hyrat e arkëtuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK).

Totali i të hyrave të arkëtuara në krahasim me vitet paraprake reflekton një rënie në inkasim për 45%. Kjo rënie ishte rezultat i pamundësisë së licencimit të KRU-ve për shkak të mungesës së menaxhmentit të lartë.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	358,733	305,145	304,579	292,008	324,106
Granti i Qeverisë - Buxheti	358,733	305,145	304,579	292,008	324,106

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 53,588€. Ky zvogëlim është bërë me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2016 ARrU ka përdorur 99% të buxhet final ose 304,578€, me një përmirësim prej 3% krahasuar me vitin 2015. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	358,733	305,145	304,579	292,008	324,106
Pagat dhe Mëditjet	217,736	186,970	186,970	177,792	188,455
Mallrat dhe Shërbimet	134,495	114,070	113,610	109,329	130,391
Shërbimet komunale	6,503	4,105	3,999	4,887	5,260

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje ishte zvogëluar me vendim të Qeverisë për 30,766€, si rezultat i suficitit për shkak të vonesave në emërimin e menaxhmentit të lartë;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte shkurtuar për 20,426€ me vendim të Qeverisë për shkak të ndryshimit të Ligjit për Prokurim Publik (LPP) ku kompetencat për të zhvilluar proceduara të prokurimit kanë kaluar tek AQP; dhe
- Buxheti për shërbime komunale është shkurtuar për 2,398€ me vendim të Qeverisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

3.1.1 Të hyrat

Për vitin 2016 ARrU ka realizuar të hyra 187,412€ apo me një rënie për afro 45% në raport me vitin paraprak. Burimi i të hyrave të ARrU-së është Taksa Vjetore për Licenca (TVL) të KRU-ve.

Çështja 6 - Dobësi në procesin e licencimit të KRU-ve - Prioritet i lartë

- E gjetura** Auditimi ynë ka identifikuar kontrolle jo efektive në procesin e licencimit të KRU-ve dhe menaxhimin e të hyrave që kanë rezultuar me dobësitë në vijim:
- Për dy (2) muajt e fundit të vitit 2015 dhe pesë (5) muaj të vitit 2016 KRU-të kishin operuar pa licenca për shkak të mungesës së menaxhmentit të lartë të ARrU-së. Këto vonesa kanë rezultuar me 210,021€ humbje për BK-në; dhe
 - ARrU nuk kishte kryer barazimet mujore me Ministrinë e Financave/ Thesarin për inkasimin e të hyrave siç kërkohet me rregullën financiare 03/2010 për të hyrat.
- Rreziku** Vonesat në licencimin e KRU-ve përveç humbjes financiare për BK-në mund të rezultojë edhe me shërbime jo cilësore të ujit për qytetarët e Kosovës. Dështimi për të kryer barazimet mujore mund të rezultojë me vlera të pasakta të të hyrave të inkasuara.
- Rekomandimi 6** Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i identifikojë mekanizmat efektiv që parandalojnë operimin e KRU-ve pa licenca dhe t'i vendos kontrollet për zbatim të plotë të tyre. Kjo mund të përfshijë informimin e Kuvendit të Kosovës për nevojën e emërimit me kohë të pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm. Raportimet/harmonizimet mujore me Thesarin duhet të kryhen në baza të rregullta për të siguruar pajtueshmëri me Rregulloren dhe që vlerat e të hyrave janë të sakta dhe të plota.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel të Institucionit kanë të bëjnë me: autorizimin e listës së pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit, barazimet me Thesarin etj. ARrU gjatë vitit 2016 ka pasur gjithsej 19 të punësuar.

Çështja 7 – Sfidat në rekrutimin e stafit – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Megjithëse kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave kanë funksionuar, disa kontrolle në menaxhimin e stafit nuk kanë qenë plotësisht efektive, si:
- Me Ligjin e ri është e paraparë Njësia për Inspektim e cila siguron mbështetje në inspektimin e përmbushjes së standardeve të shërbimeve nga ofruesit e shërbimeve të ujit. ARrU, për shkak të mungesës së buxhetit, nuk ka arritur të rekrutojë dy pozitat kyçe të kësaj Njësie (Udhëheqësit të njësisë për inspektim dhe Zyrtarit për çështje ligjore dhe licencim); dhe
 - Pozita e Zyrtarit Certifikues në ARrU nuk është specifikuar në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës respektivisht në organogram. Kjo pozite është planifikuar të kryhet nga analisti financiar i tarifave që paraqet papajtueshmëri me kërkesat që burojnë nga LMFP.
- Rreziku** Mos funksionimi i të gjitha njësive të parapara me organogram reduktojnë efektivitetin e operacioneve dhe mund të rezultojnë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe shërbime jociësore për qytetarët/konsumatorët. Mos definimi i pozitës së Zyrtarit Certifikues ndikon direkt në zbatimin e kontrolleve të brendshme.
- Rekomandimi 7** Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i rishikojë arsyet e mosrealizimit të rekrutimeve dhe të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për të adresuar çështjet e ngritura, si dhe për të shmangur pengesat e tilla në të ardhmen. Po ashtu duhet ta rishikojë pozicionin e Zyrtarit Certifikues brenda institucionit për të siguruar pavarësinë dhe funksionimin e tij sipas kërkesave mbi MFK-në.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunal në vitin 2016 ishte 118,174€. Prej tyre ishin shpenzuar 117,608€ apo 99% të buxhetit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive kapitale (mbi 1,000€) të shpalosura në PVF-të e vitit 2016 ishte 3,045€. Vlera e pasurive jo-kapitale (nën 1,000€) ishte 19,939€ ndërsa vlera e stoqeve ishte 8,721€.

Çështja 9 - Përdorimi i e-pasurisë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** ARrU nuk ka arritur ta funksionalizojë sistemin “E-pasuria” për të regjistruar pasuritë jokapitale nën 1,000€ për shkak të vështirësive për ta përdorur këtë sistem. Në mungesë të tij, këto pasuri ishin regjistruar në një dokument në excel i cili nuk përmban të dhëna të plota dhe të sakta. Për shkak të kësaj, ne nuk kemi mundur të përcaktojmë saktësinë e informatave të paraqitura në vlerë prej 19,939€.
- Rreziku** Mos regjistrimi i pasurive në sistemin e-pasuria është në kundërshtim me Rregulloren nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë. Mbajtja e pasurive në dokumente jo të plota dhe pa gjurmë mund të rezultojë në dëmtim dhe/apo humbje të pakontrolluar të pasurive dhe vlera të pasakta të tyre në PFV.
- Rekomandimi 8** Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike duhet t'i analizoj arsyet e mospërdorimit të sistemit e-pasuria dhe të shqyrtojë nevojën e trajnimeve të stafit për të siguruar se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat e Rregullores.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Saldo e llogarive të arkëtueshme të ARrU-së në fund të vitit 2016 ishte 33,394€. Çështja e mbivlerësimit të këtyre llogarive të raportuara në PFV 2016 është trajtuar në nënkapitullin 1.2 të këtij raporti.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2016 ishte 6,837€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. ARrU ka trajtuar obligimet në pajtim me kërkesat ligjore. Obligimet ishin kryesisht të ndërlidhura me faturat e pranuar pas mbylljes së afatit për pagesa.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet lidhur me klasifikimin e shpenzimeve dhe shpalosjet e duhura në PVF. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme apo rishikimet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.
2.4. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit –	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi përkatësisht vlerësimin e rrezikut dhe raportimit.		Pyetësi është plotësuar mirëpo nuk paraqet gjendjen reale për të gjitha komponentët (vlerësimin e rrezikut dhe raportime menaxheriale cilësore).	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një zyrtar përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.		Një liste formale është përpiluar por jo një regjistër të rrezikut siç e kërkon procedura e MFK-së.	
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.			Nuk janë marrë masa.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen dhe realizohen në kategoritë adekuate për të ofruar një pamje me të qartë lidhur me natyrën e shpenzimeve të realizuara dhe të prezantuara në PVF.	Po		
3.4 Prokurimi	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj realizimin e shërbimeve të telefonisë mobile përmes procedurave të duhura të prokurimit të cilat ofrojnë një blerje transparente dhe konkurruese.	Po		
3.4 Prokurimi	Drejtori i përgjithshëm duhet të siguroj funksionimin e kontrolleve adekuate me rastin e aprovimit të pagesave dhe të siguroj që me rastin e raportimit të shpenzimeve të gjitha transaksionet janë të sakta dhe të plota.	Po		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të konsiderojë llogaritjen e kostos për mënyrën e aplikimit të mëditjeve sipas rregullës për udhëtime zyrtare	Po		
3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të vazhdojë përpjekjet për të siguruar se të gjitha automjetet që i përkasin agjencisë janë regjistruar si automjete zyrtare dhe të vazhdoj përpjekjet për të siguruar tabelat zyrtare duke ndjekur kërkesat e duke ndjekur kërkesat e UA përkatës.	Po		

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



z. Raif Preteni,

Drejtore i Përgjithshëm

Data: 20.06.2017

